



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-06

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 17 qershor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i redaktuar publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar
për paraqitjen e materialeve mbështetëse shtesë**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtës i Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtës i Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtës i Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëse e Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 39(2) dhe (3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 85(5) dhe 86(3) e (4)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi për konfirmim një aktakuzë konfidenciale dhe *ex parte* (“Aktakuza”) së bashku me material provues në mbështetje të fakteve mbi të cilat bazohen akuzat dhe një përmbledhje të detajuar në të cilën tregohet lidhja e secilës provë me secilën akuzë.²

2. Më 2 qershor 2020, ZPS-ja kërkoi leje për të paraqitur material mbështetës shtesë në lidhje me Aktakuzën (“Kërkesa”).³ Ky material përfshin deklaratat e dy dëshmitarëve⁴ dhe nëntë dokumente të tjera⁵ (bashkërisht “materiale mbështetëse shtesë”). ZPS-ja parashtron se materialet mbështetëse shtesë janë në lidhje me akuzat e paraqitura në Aktakuzë.⁶ ZPS-ja parashtron gjithashtu se disa nga materialet mbështetëse shtesë janë autorizuar për përdorim vetëm kohëve të fundit nga shtete dhe organizata ndërkombëtare përkatëse.⁷ ZPS-ja më tej bën të ditur se disa nga materialet mbështetëse shtesë do të zëvendësojnë dokumente që janë dorëzuar pa dashje dhe të

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim*, 25 prill 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* me shtojcat 1-3 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-06, F00006, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë për paraqitjen e materialeve mbështetëse shtesë*, 2 qershor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 1; me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁴ [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR].

⁵ [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR].

⁶ Kërkesa, para. 2.

⁷ Kërkesa, poshtëshënimi 4.

cilat në fund do të hiqen nga paketa e materialeve mbështetëse të dorëzuara.⁸ Në shtojcën 2 të Kërkesës ("Shtojca 2"),⁹ ZPS-ja ka dorëzuar një version të përditësuar të përmbledhjes në bazë të rregullës 86(3)(b), i cili përfshin materialet mbështetëse shtesë, korrigjime gabimesh tipografike si dhe korrigjime të tjera.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Në bazë të nenit 39(2) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencën të shqyrtojë aktakuzën dhe në përputhje me rregullën 85(5) të Rregullores nxjerr vendimin e vet mbi shqyrtimin e aktakuzës jo më vonë se gjashtë muaj nga dorëzimi i aktakuzës dhe i materialit mbështetës.

4. Në bazë të rregullës 86(3) të Rregullores, aktakuza dorëzohet së bashku me material mbështetës i cili përmban një përmbledhje të detajuar ku tregohet lidhja e çdo prove me secilën akuzë.

5. Në përputhje me rregullën 86(4)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të lejojë Prokurorin e Specializuar të dorëzojë material shtesë në mbështetje të cilësdo ose të gjitha akuzave.

III. DISKUTIM

6. Kur merr vendimin për të lejuar ZPS-në që të paraqesë materiale shtesë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake veçanërisht duhet të sigurojë që shqyrtimi i aktakuzës të kryhet brenda afatit të përcaktuar në rregullën 85(5) të Rregullores.

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon para së gjithash se Kërkesa është parashtruar në kohë dhe në fazën e hershme të procesit të shqyrtimit, dhe për këtë

⁸ Kërkesa, poshtëshënimet 4 dhe 7.

⁹ Kërkesa, para. 3, poshtëshënimi 8. Shtojca 1 e Kërkesës përfshin një përmbledhje të përditësuar në bazë të rregullës 86(3)(b), në të cilën nuk përmenden materialet mbështetëse shtesë.

E mërkurë, 17 qershor 2020
Në Hagë Holandë.